




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.525/2023  
Datë: 27 nëntor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 4 dhe nenit 6 të Rregullores Nr.13/2022 Për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikqyrës, në takimin 317-të, të mbajtur me datë 27 nëntor 2023, merr këtë:

### V E N D I M

I. Themelohet komisioni ad hoc për vlerësimin e performancës së znj. Albina Shabani Rama, kryetare në Gjykatën Themelore Prishtinë, në përbërjen si në vijim:

- 1.Teuta Ibrahim, anëtare e KGJK-së/kryetare e Komisionit;
- 2.Fahret Vellija, anëtar i KGJK-së/anëtar i Komisionit;
- 3.Vilard Bytyqi, anëtar i KGJK-së/anëtar i Komisionit;
- 4.Fidan Hoxha, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë i Komisionit;
- 5.Ahmet Imami, anëtar i KGJK-së/anëtar rezervë i Komisionit;

II. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 nëntor 2023.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 24 tetor 2023 ka pranuar shkresë nga Kryetarja e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve që vlerësimi i performancës duhet të bëhet për znj. Albina Shabani Rama, e cila aktualisht e ushtron funksionin e kryetares në Gjykatën Themelore Prishtinë.

Këshilli, në takimin e mbajtur më 27 nëntor, pas shqyrtimit të shkresës përkatësisht kërkesës së kryetares së KVPGj, konform nenit 4 të Rregullores Nr.13/2022 Për Vlerësimin e Performancës të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikqyrës, ka themeluar Komisionin vlerësues në përbërjen si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë;
- Znj. Teuta Ibrahim, kryetare e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve;
- Njësisë për Inspektim Gjyqësor dhe Arkivit.

